



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Kryesia e Kuvendit

P-001

Prishtinë, më 8 dhjetor 2014, në orën 13:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË KRYESISË SË KUVENDIT, E MBAJTUR MË 8 DHJETOR 2014

Në mbledhje morën pjesë: Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit; Xhavit Haliti, Sabri Hamiti, Glauk Konjufca, Jasmina Zhivkoviç dhe Duda Balje, nënkryetarë të Kuvendit.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

Nga Administrata e Kuvendit: Ismet Krasniqi, Xheladin Hoxha, Sali Rexhepi, Shefki Shoshaj dhe Musli Krasniqi.

Mbledhjen e kryesoi **Kadri VESELI**, kryetar i Kuvendit.

Kryetari e hapi mbledhjen dhe i përshëndeti të pranishmit. Ai shprehu gatishmërinë për bashkëpunim me të gjithë anëtarët e Kryesisë së Kuvendit, duke u mbështetur në Kushtetutë, Rregullore të Kuvendit, ligje, si dhe në traditën tonë humane, me qëllim mbarëvajtjes së punës së Kuvendit dhe të zhvillimit të demokracisë parlamentare gjatë kësaj legjislatore.

Kryetari, në vazhdim procedoi me këtë:

Rend dite

1. Shqyrtimi i kërkesës së Grupit të deputetëve të Kuvendit për seancë të jashtëzakonshme, më 8 dhjetor 2014

Kryetari i njoftoi të pranishmit me përmbajtjen e kërkesës së Grupit prej 41 deputetëve të Kuvendit, që kishin parashtruar kërkesë për mbajtjen e mbledhjes së jashtëzakonshme të Kuvendit.

Ai, gjithashtu, i njoftoi anëtarët e Kryesisë edhe me Dekretin e Presidentes së Republikës së Kosovës për nominimin e kandidatit për Kryeministër të Republikës së Kosovës.

Pastaj, kryetari e hapi diskutimin lidhur me kërkesën e parashtruar nga 41 deputetë.

Lidhur me kërkesën e lartshënuar diskutuan: Jasmina Zhivković, Glauk Konjufca, Xhavit Haliti, Duda Balje dhe Sabri Hamiti, anëtarë të Kryesisë. Diskutimet e plota të tyre janë dhënë në transkript.

Në fund, Kryesia njëzëri vendosi që mbledhja e jashtëzakonshme e Kuvendit të mbahet më 8 dhjetor 2014, në orën 16:00, me këtë:

Rend dite

1. Zgjedhja e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Kryetari e deklaroi të mbyllur mbledhjen e Kryesisë në orën 13:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale